



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E MBROJTJES
MINISTRI

Nr. 1226 / prot.

Tiranë, më 24.05.2018

URDHËR

Nr. 719, datë 24.05.2018

PËR

**MIRATIMIN E RREGULLORES "PËR ORGANIZIMIN DHE FUNKSIONIMIN E
KOMISIONIT TË SHQYRTIMIT TË ANKESAVE PËR VLERËSIMIN E
USHTARAKËVE NGA KOMISIONET E KARRIERËS"**

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të ndryshuar; të shkronjës "nj", të pikës 2, të nenit 13, të ligjit nr. 64/2014 "Për pushtetet dhe autoritetet e drejtimit e të komandimit të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar; nenit 113, të ligjit nr. 44/2015 "Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë",

URDHËR O J:

1. Miratimin e rregullores "Për organizimin dhe funksionimin e komisionit të shqyrtimit të ankesave për vlerësimin e ushtarakëve nga komisionet e karrierës", bashkëlidhur dhe pjesë e pandarë e këtij urdhri.
2. Urdhri i ministrit të Mbrojtjes nr. 1216, datë 15.09.2014 "Për miratimin e Rregullores për organizimin dhe funksionimin e komisionit të shqyrtimit të ankesave për vlerësimin e ushtarakëve nga komisionet e karrierës", shfuqizohet.
3. Përgjigjen për zbatimin e këtij urdhri: Komisioni i Shqyrtimit të Ankesave, Drejtoria e Mirëadministrimit të Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve, Komandat e Forcave/komandat mbështetëse, komandat dhe drejtuesit e strukturave në varësi të drejtpërdrejtë të MM-së dhe SHP-së, drejtoritë në Ministrinë e Mbrojtjes dhe në Shtabin e Përgjithshëm të FA-së.
4. Ndjekin zbatimin e këtij urdhri sekretari i përgjithshëm dhe shefi i Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.





**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E MBROJTJES**

RREGULLORE

**PËR
ORGANIZIMIN DHE FUNKSIONIMIN E KOMISIONIT TË SHQYRTIMIT TË
ANKESAVE PËR VLERËSIMIN E USHTARAKUT NGA KOMISIONET E
KARRIERËS**

Miratuar me urdhër të ministrit të Mbrojtjes

Nr. 719, datë 24.05.2018

Tiranë, 2018

Neni 1

Objekti

Objekti i kësaj rregulloreje është përcaktimi i procedurave të punës që do të ndjekë dhe do të zbatojë Komisioni i Shqyrtimit të Ankesave (KSHA) për shqyrtimin e ankesave të ushtarakëve, në lidhje me vlerësimet që kanë bërë komisionet e karrierës për përparimin në gradë të tyre.

Neni 2

Qëllimi

Qëllimi i kësaj rregulloreje është të sigurojë që ankesat e ushtarakëve për vlerësimin e tyre nga komisionet e karrierës të shqyrtohen në mënyrë të drejtë, të paanshme, objektive, transparente dhe në përputhje me kërkesat e ligjit nr. 59/2014, datë 12.6.2014 “Për karrierën e ushtarakut në Forcat e Armatosura”, i ndryshuar dhe kërkesat e rregulloreve të komisioneve të karrierës.

Neni 3

Statusi

1. Në bazë të nenit 28, pika 2, të ligjit nr. 59/2014, datë 12.6.2014 “Për karrierën e ushtarakut në Forcat e Armatosura”, i ndryshuar, Komisioni i Shqyrtimit të Ankesave, krijohet me urdhër të ministrit të Mbrojtjes, me propozimin e shefit të Shtabit të Përgjithshëm. Ai është përgjegjës për të shqyrtuar të gjitha ankesat e ushtarakëve për procedurat dhe mënyrën e vlerësimit të tyre nga komisionet e karrierës për promovimin në gradë.
2. Në bazë të nenit 28, pikës 3 të këtij ligji, Komisioni i Shqyrtimit të Ankesave vendos lënien në fuqi të vlerësimit të komisionit të karrierës ose ndryshimin e këtij vlerësimi.

Neni 4

Përbërja e Komisionit të Shqyrtimit të Ankesave

1. Në bazë të nenit 28, pika 1, të ligjit nr. 59/2014, datë 12.6.2014 Për karrierën e ushtarakut në Forcat e Armatosura”, i ndryshuar, KSHA-ja drejtohet nga një ushtarak me gradë më të lartë.
2. KSHA-ja përbëhet nga 7 veta, si më poshtë:
 - a. një gjeneral brigade ose gjeneral major, kryetar;
 - b. gjashtë kolonelë, anëtarë.
3. Anëtarët e KSHA-së nuk mund të jenë anëtarë të komisioneve të karrierës.
4. Në ndihmë të Komisionit të Shqyrtimit të Ankesave caktohet një sekretar, i cili duhet të jetë një ushtarak i Drejtorisë së Mirëadministrimit të Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve ose Drejtorisë së Personelit në SHP.
5. Anëtarët dhe sekretari nuk mund të jenë ushtarakë të cilët janë shqyrtuar nga komisionet e karrierës për përparimin në gradë ose kualifikimin e mëtejshëm institucional.

Neni 5

Detyrat e Komisionit

Detyrat e Komisionit të Shqyrtimit të Ankesave janë:

1. të zbatojë kërkesat e ligjit nr. 59/2014 “Për karrierën e ushtarakut në Forcat e Armatosura”, i ndryshuar, aktet e tjera ligjore e nënligjore që lidhen me procedurat e punës së këtij komisioni, si dhe kërkesat e kësaj rregulloreje;
2. të sigurojë që ankesat e ushtarakëve për vlerësimin e komisioneve të karrierës për promovimin në gradë dhe për kualifikimin e ardhshëm të shqyrtohen me paanshmëri, objektivitet, besueshmëri, ndershmëri dhe transparencë;
3. të vlerësojë nëse ankesat e paraqitura janë ose jo në përputhje me kërkesat e ligjit nr. 59/2014 “Për karrierën e ushtarakut në Forcat e Armatosura”, i ndryshuar dhe kërkesat e rregullores “Për organizimin dhe funksionimin e komisionit të veçantë të karrierës” dhe rregullores “Për organizimin dhe funksionimin e komisionit të lartë dhe komisioneve të zakonshme të karrierës”;
4. KSHA-ja shqyrton vetëm rubrikat për të cilat janë ankuar ushtarakët. Kur vëren se ankesat janë të bazuara në ligj dhe në aktet e tjera nënligjore, formulon me shkrim arsyet e konsiderimit të ankesës, si dhe bën rivlerësimin e ushtarakut për rubrikën për të cilën ai është ankuar, pa ndërhyrë në vlerësimin e përgjithshëm që ka bërë komisioni përkatës i karrierës;
5. veprimtaria, mendimet dhe diskutimet e komisionit nuk bëhen publike. Anëtarët e komisionit dhe sekretari nuk mund t'i japin informacion të tjerëve lidhur me diskutimet dhe vendimet e komisionit.

Neni 6

Përgjegjësitë e kryetarit të Komisionit të Shqyrtimit të Ankesave

Kryetari i Komisionit të Shqyrtimit të Ankesave ushtron këto përgjegjësi:

1. organizon mbledhjen dhe veprimtarinë e komisionit sipas kërkesave të kësaj rregulloreje;
2. drejton diskutimet gjatë mbledhjeve të komisionit. Kryetari shprehet i fundit pas diskutimeve për vlerësim;
3. gjatë vlerësimit të ankesave, siguron zbatimin e ligjit nr. 59/2014 “Për karrierën e ushtarakut në Forcat e Armatosura”, i ndryshuar, të rregulloreve të komisioneve të karrierës, si dhe të kërkesave të kësaj rregulloreje;
4. kërkon me shkresë zyrtare nga sekretaria e SHP-së, materialin e regjistruar audio dhe video që i përket veprimtarisë së KKK-së dhe KVK-së. Në përfundim të procedurës së punës regjistrimet audio dhe video kthehen përsëri zyrtarisht në Sekretarinë e SHP-së;
5. për çdo parregullsi të vërejtur gjatë procedurës së komisioneve të karrierës dhe që e gjykon se duhet rregulluar, kërkon zyrtarisht rregullimin e saj nga QPR-ja dhe më pas kalimin në databazën e të dhënave vetëm pjesën e korrigjuar;
6. nënshkruan procesverbalet e mbledhjeve të komisionit, pas nënshkrimit nga të gjithë anëtarët dhe sekretari i komisionit;

7. në përfundim të shqyrtimit të ankesave, kryetari i komisionit, nëpërmjet SHSHP-së, i paraqet ministrit të Mbrojtjes:
- listën e ushtarakëve të ankuar;
 - vendimet që KSHA-ja ka marrë për shqyrtimin e ankesave;
 - relacionin e KSHA-së ;
 - listën përfundimtare të renditjes së ushtarakëve të vlerësuar nga komisioni i lartë dhe komisionet e zakonshme, të nxjerrë nga sistemi i automatizuar pas vlerësimit të ankesave, si dhe dosjet individuale me vlerësimin përkatës të bërë nga KSHA-ja për ushtarakët e ankuar, të cilët janë vlerësuar nga KVK-ja për përparimin në gradë.

Neni 7

Përgjegjësitë e sekretarit të Komisionit të Shqyrtimit të Ankesave

Sekretari i KSHA-së ka këto përgjegjësi:

1. evidenton të gjitha ankesat që i janë adresuar komisionit;
2. mbështet KSHA-në me materialet e nevojshme për kryerjen e detyrës (kancelari, dosjet individuale elektronike, dosjet fizike, regjistrimet audio dhe video apo të dhëna të tjera të nevojshme për mbarevajtjen e punës së komisionit);
3. siguron lajmërimin e të gjithë anetarëve të komisionit për vendin, kohën dhe qëllimin e mbledhjes;
4. mban procesverbalin e mbledhjes së komisionit;
5. administron materialin audio dhe video të punës së KKK-së dhe KVK-së për personelin e ankimuar, të marrë nga sekretaria e SHP-së, sipas rregullave në fuqi.
6. përgatit relacionin e shqyrtimit të ankesave në emër të kryetarit të komisionit.

Neni 8

Detyrat e organeve të tjera për mbështetjen e KSHA-së

1. **Qendra e Personel-Rekrutimit** mbështet KSHA-në me dokumentacion shtesë për ushtarakët që janë ankuar, me dosjet individuale elektronike, me dosjet fizike dhe çdo të dhënë tjetër ose informacion që komisioni kërkon në lidhje me objektin e ankesës së çdo ushtaraku. Ajo gjithashtu, mbështet KSHA-në me sistemin e automatizuar të të dhënave, duke i ofruar akses vetëm për rubrikën për të cilën ushtaraku është ankuar dhe vetëm për ushtarakët që janë ankuar.
2. **Drejtoria e Mirëadministrimit të Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve**, nëpërmjet Sektorit të Sekretarisë në MM, i përcjell sekretarit të KSHA-së, ankesat e ushtarakëve. Sekretari, pasi studion të gjitha ankesat, informon kryetarin e KSHA-së për numrin e tyre, kategoritë e ushtarakëve të ankuar, objektin e ankimit dhe problematikat e konstatuara. DMBNJSH-ja, pas miratimit nga ministri të relacionit dhe propozimeve për gradime, përgatit praktikat për nxjerrjen e akteve për dhënien e gradave.
3. **Drejtoria e Personelit në Shtabin e Përgjithshëm (J-1)**, mbi bazën e listës përfundimtare të komisioneve të karrierës dhe listës së Komisionit të Shqyrtimit të Ankesave, përgatit për SHSHP-në, sipas gradave dhe specialiteteve, nëpërmjet sistemit të

automatizuar të të dhënave, listat përfundimtare të klasifikimit të nënoficerëve për përparimin në gradë për vitin përkatës.

4. **Agjencia e Sistemeve të Ndërlidhjes dhe Informacionit (ASNI)**, mbështet KSHA-në nga ana teknike për mirëfunksionimin e SIMBM-së, si dhe siguron akses në SIMBM për rubrikat që do të merren në konsideratë nga KSHA-ja, për personelin e ankimuar. Ky akses jepet pas shkresës së kryetarit të Komisionit të Shqyrtimit të Ankesave. Gjithashtu siguron personel teknik që do të bëjë të mundur njohjen nga KSHA-ja të regjistrimit audio dhe video të punës së KLLK-së dhe KVK-së, vetëm për personelin e ankimuar.

Neni 9

Procedura për përgatitjen e ankesave nga ushtarakët

1. Në bazë të nenit 28, pika 1, të ligjit nr. 59/2014, datë 12.6.2014 “Për karrierën e ushtarakut në Forcat e Armatosura”, i ndryshuar, ushtarakët që janë marrë në shqyrtim për gradën e radhës, mund të ankohen për vlerësimin e Komisionit të Karrierës te ministri i Mbrojtjes.
2. Ankesa bëhet vetëm një herë dhe është e vlefshme kur paraqitet brenda 10 ditëve nga data e shpalljes së rezultatit. Ankesa paraqitet me shkrim.
3. Ankesa përmban: emrin, mbiemrin, gradën, detyrën që ushtaraku kryen aktualisht, adresën e repartit ku ushtaraku shërben dhe objektin e ankesës.
4. Objekti i ankesës duhet të jetë i specifikuar vetëm për ato çështje për të cilat ankuesi gjykon se vlerësimi nuk është bërë i saktë.
5. Ankuesi mund të përcjellë ankesën, përmes degëve të sekretarive të komandave të njëjësive, reparteve apo nënreparteve ku shërben ose nëpërmjet Shërbimit Postar Shtetëror.

Neni 10

Procedurat e punës së KSHA-së

1. KSHA-ja ushtron veprimtarinë e tij në bazë të ligjit nr. 59/2014, datë 12.6.2014 “Për karrierën e ushtarakut në Forcat e Armatosura”, të rregullores “Për organizimin dhe funksionimin e komisioneve të karrierës” dhe të kërkesave të kësaj rregulloreje.
2. Në fillim të veprimtarisë së Komisionit të Shqyrtimit të Ankesave, kryetari njihet anëtarët me ligjin nr. 59/2014, datë 12.6.2014 “Për karrierën e ushtarakut në Forcat e Armatosura”, të ndryshuar, me rregulloren “Për organizimin dhe funksionimin e komisionit të lartë dhe komisioneve të zakonshme të karrierës”, me rregulloren “Për organizimin dhe funksionimin e komisionit të veçantë të karrierës” dhe me procedurat e punës të përcaktuara në këtë rregullore.
3. Pas njohjes me bazën ligjore për ushtrimin e veprimtarisë, anëtarët e komisionit njihen me të gjitha ankesat që i janë adresuar komisionit, me të dhënat e secilit nëpërmjet dosjes elektronike dhe fizike dhe analizojnë e vlerësojnë bazueshmërinë e tyre ligjore.
4. Në përfundim të njohjes, nën drejtimin e kryetarit të Komisionit të Shqyrtimit të Ankesave, anëtarët e KSHA-së diskutojnë për secilën ankesë. Gjatë diskutimeve kryetari i Komisionit të Shqyrtimit të Ankesave shprehet i fundit.

5. Komisioni mund të thërrasë dhe të dëgjojë, kur e gjykon të arsyeshme, edhe ushtarakun e ankuar.
6. Sekretari evidenton mendimet, diskutimet dhe vlerësimet që jep çdo anëtar i komisionit për secilin ankues.
7. Diskutimet e çdo anëtari, për çdo ankues, përmbledhen në një gjykim të përbashkët të komisionit.
8. Në vijim, Komisioni i Shqyrtimit të Ankesave harton listën e ushtarakëve që janë ankuar dhe vlerësimin e komisionit për bazueshmërinë ligjore për çdo ankesë.
9. Për të gjitha ankesat, të cilat komisioni i gjykon të bazuara, i konsideron ato dhe bën vlerësimin përkatës.
10. Vlerësimi bëhet vetëm për rubrikën për të cilën ushtaraku ka bërë ankesë.
11. Vlerësimi i ankesave që i referohen intervistës me pyetje, bëhet nëpërmjet rishikimit dhe rivlerësimit të përgjigjeve të pyetjeve të regjistruara audio dhe video. Komisioni, kur kërkohet, thërret edhe ushtarakun e ankuar për të asistuar në procesin e rishikimit të regjistrimit të përgjigjeve të pyetjeve.
12. Vlerësimi i rubrikës së ankimit dhe rillogaritja e pikëve bëhet në bazë të procedurave dhe metodologjisë së përcaktuar në rregulloren "Për organizimin dhe funksionimin e komisioneve të karrierës". Rillogaritja bëhet nëpërmjet sistemit në mënyrë elektronike.
13. Jo më vonë se 24 orë nga përfundimi i procesit të shqyrtimit të ankesave, komisioni dërgon te ministri propozimet, shoqëruar me relacionin përkatës, ku pasqyron veprimtarinë e vet, si dhe listën e përgjithshme të ushtarakëve të ankuar; listën e ankuesve për të cilët komisioni gjykon se ankesat nuk janë të bazuara; listën e ankuesve për të cilët komisioni vlerëson se ankesat janë të bazuara ligjërisht; duke pasqyruar për secilin pikët e rillogaritura. Gjithashtu, i paraqet ministrit listën përfundimtare të renditjes së ushtarakëve të vlerësuar nga komisionet e karrierës, pasi procesi i ankimit është mbyllur, e cila nxirret nga sistemi elektronik.
14. Dokumentet nënshkruhen nga të gjithë anëtarët e komisionit. Në qoftë se ndonjë nga anëtarët e komisionit ka mendim ndryshe, shpreh me shkrim arsyet e tij.
15. Për procedurë, dokumentet e mësipërme i dërgohen ministrit të Mbrojtjes, nëpërmjet shefit të Shtabit të Përgjithshëm të FA-së.
16. Në vijim Komisioni të Shqyrtimit të Ankesave përgatit dhe dërgon përgjigje me shkrim për secilin ushtarak që është ankuar brenda 30 ditëve nga afati i fundit për paraqitjen e ankesës nga ushtaraku.